



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

VENDIM

**PËR REZULTATIN E SHORTIT PËR CAKTIMIN E RELATORIT TË KËRKESËS ANKIMORE
NR. 04, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN 27.05.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimin e Anëtarit të KQZ-së që do të verifikojë dhe relatojë kërkesën ankimore nr.04 të paraqitur më datë 27.05.2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a" dhe neni 129, pika 1 të ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V Ë R E N:

Në mbledhjen e datës 27.05.2019, ora 18:00, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 129, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Vendimin e KQZ-së nr. 21, datë 29.01.2013 "Për miratimin e rregullave për hedhjen e shortit për caktimin e anëtarëve të KQZ-së që relatojnë kërkesat ankimore të regjistruara në KQZ", procedoi me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore me nr. 04 regjistri, të paraqitur në KQZ në datë 27.05.2019.



PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, dhe nenin 129 pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Kërkesa ankimore e depozituar dhe e regjistruar me nr. 04, regj, datë 27.05.2019 në regjistrin e ankimeve zgjedhore në KQZ, do të relatohet nga z. Klement Zguri.
2. Relatimi do të bëhet në datën 27.05.2019, në orën 18:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 667 i Vendimit **Data 27.05.2019** **Ora 18:00 e Vendimit**

Për rezultatin e shortit për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 04,
të paraqitur në KQZ në datën 27.05.2019